2. **Увид у документацију: графички преглед катастарских парцела по катастарским општинама и списак парцела по формираним јавним надметањима (комплексима), која су предмет издавања у закуп и на коришћење, може се извршити у згради Општине Бујановац, у канцеларији бр 308 сваког радног дана од 08:00 до 14:00 часова. Контакт особа Реџеп Адили, тел. 017/651-103, локал 122.**
   **Shikim në dokumentacionin: pasqyra grafike e ngastrave kadastrale sipas komunave kadastrale dhe lista e parcelave për ankandet e formuara publike (komplekset), të cilat janë objekt i dhënies me qira dhe në shfrytëzim, mund të bëhet në ndërtesën e komunës së Bujanocit, në zyrën nr 308, në çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 14:00. Personi kontaktues Rexhep Adili, tel.017 / 651-103, lokali 122 .**

3. **Земљиште из овог огласа даје се у виђеном стању.**
   Toka nga kjo shpallje jepet në gjendjen siç është.

4. **Обилазак пољопривредног земљишта, које се даје у закуп и на коришћење, може се извршити за све катастарске општине од 21.08.2017 до 08.09.2017.године, сваког радног дана од 08:00 до 14:00 часова.**
   Kontrolli i tokës bujqësore, e cila ipet me qira dhe në shfrytëzim, mund të kryhet në të gjitha komunat kadastrale nga data 21.08.2017 deri më 08.09.2017, në çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

5. **Уколико након расписивања Огласа за јавно надметање за закуп и на коришћење пољопривредног земљишта у државној својини, дође до промена површине из огласа по било ком законском основу, даљи поступак давања пољопривредног земљишта у закуп и коришћење ће се спровести само за тако утврђену површину земљишта.**
   Nëse pas Shpalljes së konkursit për ankand publik për dhënien me qira dhe në shfrytzim të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, vie tek ndonjë ndryshim nga shpallja në çfardo bazë ligjore, procedura e mëtejshme për dhënien e tokës bujqësore në qira dhe në shfrytzim do të kryhet vetëm për atë sipërfaqe të caktuar të tokës.

6. **Све трошкове који настану по основу закупа и коришћења пољопривривредног земљишта у државној својини сноси лице које добије то земљиште у закуп, односно на коришћење.**
   Të gjitha shpenzimet që dalin në bazë të qiras dhe shfrytzimit të tokës bujqësore në pronësi të shtetit do ti bartë i cili merr me qira tokën, përkatsisht në shfrytzim.

7. **Земљиште из овог Огласа даје се у закуп и на коришћење искључиво за пољопривредну производњу, не може се користити у друге сврхе.**
   Toka nga kjo shpallje jepet me qira dhe në shfrytzim ekskluzivisht për prodhimtarin bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

8. **Пољопривредно земљиште у државној својини груписано у јавна надметања**

**означена * и ** у табели тачке 1. овог огласа није било издато најмање последње три агроекономске године и није било предмет коришћења.**
Toka bujqësore në pronësi të shtetit është grupuar në ankand publikë të shënuar * dhe ** në tabelën nga pika 1. të kësaj shpallje nuk është lëshuar të paktën tre vjet të fundit të vitit agroekonomik dhe nuk ka qenë subjekt i shfrytzimit.

9. **Земљиште из овог огласа не може се давати у подзакуп.**
Toka nga kjo shpallje nuk mund të jepet në nënqira.

**II**

-Услови за пријављивање на јавно надметање-

**- Kushtet për paraqitje në ankand publik -**

1. Право учешћа у јавном надметању за давање у закуп пољопривредног земљишта у државној својини има:
Të drejtë për të marrë pjesë në ankandin publik për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit ka:

- **физичко лице** које је уписано у Регистар пољопривредних газдинстава и налази се у активном статусу најмање **три године** , са пребивалиште најмаље **три године** у катастарској општини на којој се налази земљиште које је предмет закупа и које је власник најмање 0,5 ха пољопривредног земљишта;
**personi fizik** i cili është i regjistruar në Regjistrin e ekonomisë bujqësore dhe është me status aktiv të paktën tre vjet, me banim të paktën tre vjet në komunën kadastrale në të cilën gjendet toka e cila është objekt i qiras dhe i cili zotëron të paktën 0.5 ha tokës bujqësore;

- **физичко лице** –уписано у Регистар пољопривредних газдинстава и налази се у активном статуду најмање **три године,** са пребивалиштем најмање три године на територији јединице локалне самоуправе која спроводи јавно надметање, а чија се парцела граничи са земљиштем у државној својини које је предмет закупа;
**personi fizik** - i regjistruar në Regjistrin e ekonomis Bujqësore dhe është me status aktiv të paktën tre vjet, me vendbanim të paktën tre vjet në territorin e njësis së vetëadministrimit lokal që kryen ankandin publik, dhe parcela e të cilit kufizohet me tokën në pronësi shtetërore e që është objekt i qirasë;

- **правно лице** које је уписано у Регистар пољопривредних газдинстава и налази се у активном статусу најмање **три године,** које је власник пољопривредног земљишта најмање 10 ха у катарстарској општини у којој се налази земљиште које је предмет закупа и има седиште на територији јединице локалне самоуправе којој припада та катастарска општина.
**personi juridik** i cili është i regjistruar në Regjistrin e ekonomive bujqësore dhe është me status aktiv të paktën tre vjet, që është pronar i tokës bujqësore të paktën me 10 ha në komunën kadastrale në të cilën gjendet toka e cila është objekt i qiras dhe ka vendbanim në territorin e njësis së vetëadministrimit lokal të cilës i përket kjo komunë kadastrale.

2. Право учешћа у јавном надметању за давање на коришћење пољопривредног земљишта у државној својини за бројеве јавних надметањеа оузначених *и** у табели тачке 1. овог огласа има:
E drejta për të marrë pjesë në procesin e ankandit publik për dhënien në shfrytzim të tokës bujqësore në pronësi shtetërore për numrat të ankandit publik të shënuar * dhe ** në pikën 1. të tabelës të kësaj shpallje ka:

- физичкло и правно лице које је уписано у Регистар пољопривредних газдинстава и налази се у активном статусу **– за пољопривредну производњу;**
person fizik ose juridik i cili është i regjistruar në Regjistrin e ekonomive bujqësore dhe është me status aktiv - për prodhimtarinë bujqësore.

- физичко и правно лице које је уписано у Rегистар пољопривредних газдинстава и налази се у активном статусу, уз обавезу да у року наведеном у уговору о коришћењу прибаве одобреље за инвестицијоне радове које даје Министарство и то у складу са чланом 67. Закона о поњопривредном земњиштом – **за производњу енергије из обновљивих извора од биомасе и сточарства.**
person fizik ose juridik i regjistruar në Regjistrin e ekonomive bujqësore dhe është me status aktiv, në varësi të afatit kohor të specifikuar në kontratë mbi shfrytëzimin të marrë pëlqimin për projektet e investimeve të nxjerra nga Ministria dhe në përputhje me nenin 67 të Ligjit mbi tokën bujqësore - **për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme të biomasës dhe blegtorisë.**

3. Испуњеност услова за пријављивање на јавно надметање за закуп пољопридног земљишта у државној својини понуђач доказује фотокопијама следећих докуменатацијом:
Plotësimi i kushteve për paraqitje në ankandin publik për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit ofertuesi paraqet fotokopjet e këtyre dokumenteve të mëposhtme:

- доказ о месту пребивалишта три године за физичка лица;
dëshmi mbi vendbanimin në tre vitet për personat fizik;
- извод из привредног регистра ( не старији од шест месеци до дана објављивања огласа) као доказ да има седиште на територији јединице локалне самоуправе којој припада катастарска општина у којој се налази земљиште које је предмет закупа за правна лица;
ekstrakt nga regjistri ekonomik (jo më i vjetër se gjashtë muaj deri në datën e postimit të shpalljes ) si dëshmi se ka selinë në territorin e njësis së vetëqeverisjes lokale të cilës i takon komuna kadastrale në të cilën gjendet toka e cila është objekt i qiras për persona juridik;

- потврда о активном статусу из Регистра пољопривредних газдинстава за три године;
vërtetimi mbi statusin aktiv në Regjistrin e ekonomive bujqësore për tre vitet;

- извод из јавне евиденције о непокретности као доказ о власништво најмање 0,5 ха пољопривредног земљишта за физичка лица ( не старији од шест месеци );
ekstrakt nga të dhënat publike të pasurive të patundshme si dëshmi e pronësisë së paku 0.5 ha tokë bujqësore për personat fizikë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);

- извод из јавне евиденције о непокретности и катастарски план као доказ о власништву пољопривредног земљишта које се граничи са земљиштем које је предмет закупа за физичка лица ( не старији од шест месеци );
ekstrakt nga të dhënat publike të pasurive të patundëshme dhe planin katasral si dëshmi mbi pronësin e bujqësore e cila kufizohet me tokën që është objekt i qiras për personat fizik (jo më e vjetër se gjashtë muaj);

- извод из јавне евиденције о непокретности ка доказ о власништву најмање 10 ха пољопривредног земљишта правног лица у катастарској општини укојо се налази земљиште које је предмет закупа ( не старији од шест месеци ).
ekstrakt nga të dhënat publike të pasurive të patundshme si dëshmi e pronësisë së paku 10 ha tokë bujqësore për personat juridikë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);

4. Испуњеност услова за пријављивање кориушћење пољопривредног земљишта у државној својини за пољопривредну производњу за бројеве јавних надметања означених * у табели тачке 1. овог огласа понуђач доказује фотокопијама следећи докумената:
Plotësimi i kushteve për regjistrim për shfrytëzimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit për prodhimtarin bujqësore për numërat e ankandit publikë shënuar * në pikës 1.të tabelës të kësaj shpalljeje ofertuesi dëshmon fotokopjet e këtyre dokumenteve të mëposhtme:

- фотокопијом личне карте или о читаном личном картом за личне карте са чипом за физичка лица, односно фотокопијом извода из привредном регистра ( не старији од шест месеци до дана објављиваља огласа) за правна лица;
Fotokopje e letërnjoftimit ose letërnjoftimit të lexuar nga letërnjoftimi me kode kartës për personat fizik, përkatsisht fotokopjen e ekstraktit nga regjistri ekonomik ( jo më i vjetër se gjashtë muaj deri në ditën e shpalljes) për personat juridikë;

- потврда о активном статусу у Регистру пољопривредних газдинстава.
vërtetimin e statusit aktiv në regjistrin e ekonomive bujqësore

5. Испуњеност услова за пријављивање на јавном надметање за коришћење пољопривредном земљишта у државној својини за производњу енергије из обновљивих извора од биомасе и сточарства понуђач за бројеве јавних надметања означених ** у табели тачке 1. овог огласа доказује фотокопијама следећих докумената:
Plotësimi i kushteve për paraqitje në ankand publik për shfrytzimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa dhe ofertuesi blegtorial për numrate ankandit publikë të shënuar ** në pikën 1. të tabelës të kësaj shpallje dëshmon fotokopjen e këtyre dokumenteve të mëposhtme:

- потврда о активном статусу у Регистру пољопривредних газдинстава;
  vërtetimin e statusit aktiv në Regjistrin e ekonomive bujqësore

- **за правна лица** – извод из привредног регистра ( не старији од шест месеци до дана објављивања огласа) са податком да је лице регистровано за производњу енергије из обновљиви извора од биомасе и сточарства и енергетска дозвола односно сагласност надлежног органа, коју доставља најкасније у року од две године од дана закључења Уговора о коришћењу са Министарством пољопривреде и заштите животне средине;
  **për persona juridik-** ekstrakt nga regjistri ekonomik (jo më i vjetër se gjashtë muaj deri në datën e shpalljes) me të dhënat se personi i regjistruar për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa dhe blegtoria dhe licencën e energjisë përkatsisht pëlqimin ose e organit kompetent, e cila duhet të dorëzohet në afat prej dy vjet pas përfundimit të Kontratës mbi shfrytzimin me Ministrin e bujqësisë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësorë;

- **за физичка лица** Уговор са произвођачем енергије кога снабдева сировином, а који има енергетску дозволу односно сагласност надлежног органа;
  **për personat fizik** Kontrata me prodhuesin e energjisë që furnizon me lëndë të parë, e cila ka lejen e energjis, përkatsisht pëlqimin e organit kompetent;

6. Понуђачи су дужни да пре почетка јавног надметања доставе оригинале докумената из тачака 3, 4. и 5. овог одељка на увид Комисији за спровођење поступка јавног надметања. Најповољнији понуђач је дужан да након закључења записника са јавног надметања, преда оригинале докумената из тачака 3, 4. и 5. овог одељка Комисији за спровођење поступка јавног надметања, која разматра документацију и утврђује испуњеност услова из овог огласа.
   Ofertuesit janë të detyruar të fillojnë para ankandit ti paraqesin dokumentet origjinale nga pikat 3, 4. dhe 5. të këtij seksioni të Komisionit për zbatimin e procedurës së ankandit. Ofertuesi më i volitshëm është i detyruar që pas përfundimit të procesverbalit të ankandit publik, ti dorëzoj dokumentet origjinale të përmendura në pikat 3, 4. dhe 5. të këtij seksioni Komisionit për zbatimin e procedurës së ankandit, i cili shqyrton dokumentacionin dhe përcakton plotësimin e kushteve nga kjo shpallje.

7. Понуђачи или његово овлашћени представник дужан је да присуствује јавном надметању, у супротном се сматра да је одустао од јавног надметања.
   Ofertuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar është i detyruar të marrë pjesë në ankandin publik, përndryshe konsiderohet se është tërhequr nga ankandit publik.

8. Овлашћени представник понуђача дужан је да достави оверено пуномоћје од стране надлежног органа Комисији за спровођење поступка јавног надметања пре почетка јавног надметања.Овлашћени представник може заступати само једног понуђача на јавном надметању.
   Përfaqësuesi i autorizuar i ofertuesit është i detyruar të paraqesë autorizimin e vërtetuar nga ana e organit kompetent Komisionit për zbatimin e procedurës së ankandit para fillimit të ankandit. Përfaqsuesi i autorizuar mund të përfaqësojë vetëm një ofertues në ankand publik.

9. Понуђачи су дужни да заједно са пријавом за јавно надметање доставе доказ о уплати депозита у тачном динарском износу наведеном у табели из тачке 1. овог огласа, за свако јавно надметање појединачно, на рачун Општинске управе Бујановац број**: 840 – 741522843 - 14** модел **97** са позивом на број **08-030**.
   Ofertuesit janë të obliguar që së bashku me fletëparaqitjen për ankand publik të praqesin dëshmi mbi pagesën e depozitit në dinarë në vlerën e saktë në tabelën pika 1. të kësaj shpallje, për çdo ankand publik individualisht, në llogarinë e Administratës komunale së Bujanocit numër: **840 – 741522843 - 14** model **97** me numër referencës **08-03**;

10. Свим понуђачима, осим најповољнијем, уплаћени депозит ће се вратити након јавног надметања. Најповољнијем понуђачу депозит ће бити урачунат у годишњу закупнину. У случају да најповољнији понуђач одустане од своје понуде депозит се не враћа. Депозит се не враћа ни понуђачу који је одлуком Комисије за спровођење поступка јавног надметања удаљен са јавног надметања због нарушавања реда и дисциплине.
    Të gjithë ofertuesëve, përveç më të volitshmit, depozitat e paguara do të i kthehen pas ankandit publik. Ofertuesit më të mirë depoziti do t'i llogaritet në qiran vjetore.

Në rast se ofertuesi më i mirë tërhiqet depozita e ofertës nuk do t'i kthehet. Depozit nuk do t'i kthehet edhe ofertuesit që me vendim të Komisionit për zbatimin e procedurës së ankandit pezullohet nga ankandi për shkelje të rendit dhe disiplinës.

11. Уколико излицитирана цена прелази двоструки износ почетне цене, потребно је да сви понуђачи који настављају надметање, допуне депозит до 50% излицитиране цене. Надметање се наставља после уплате депозита.
Në qoftë se çmimi i ofruar tejkalon dyfishin e shumës së çmimit fillestar, është e nevojshme që të gjithë ofertuesit të cilët e vazhdojnë ankandin, të plotësoj depozitin deri në 50% të çmimit të ofruar.Ankandi vazhdon pas pageses së depozitit.

12. Јавно надметање ће се одржати уколико буде благовремено достављена најмање једна пријава.
Ankandi publik do të mbahet në qoftë se dorëzohet me kohë të paktën një aplikim.

13. Право закупа и коришћења пољопривредног земљишта у државној својини немају правна и физичка лица уписана у Регистар пољопривредних газдинстава која:
Të drejta për qira dhe shfrytzimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit nuk kanë të drejt personat juridikë dhe fizikë që nuk janë në Regjistrin e ekonomive bujqësore:

1) су у пасивном статусу;
janë me status pasiv ;
2) нису испунила све обавезе из претходних или текућих уговора о закупу пољопривредног земљишта у државној својини;
nuk kanë përmbushur të gjitha obligimet nga kontrata e mëparshëm ose aktuale me qira për tokën bujqësore në pronësi të shtetit;
3) су извршила ометање поседа пољиопривредног земљишта у државној својини;
të kenë kryer pengimin e posedimit të tokës bujqësore në pronësi të shtetit ;
4) су нарушавала несметано одвијање било ког дела поступка јавног надметања приликом давања пољопривредног земљишта у државној својини у закуп;
kanë penguar funksionimin normal të çdo pjesë të procedurës së ankandit publik, gjatë dhënies së tokës bujqësore në pronësi të shtetit në qira;
5) су бесправно користила пољопривредно земљиште у државној својини;
kanë përdorur në mënyrë të paligjshme tokën bujqësore në pronësi të shtetit;
6) су дала закупљено пољопривредно земљиште у државној својини у подзакуп.
kanë dhënë tokën e blerë bujqësore në pronësi të shtetit në nënqira.

**III**

– Документација за пријављивање на јавно надметање –

**- Dokumentacioni për aplikimet për tender –**

**формулар за пријављивање (попуњен у целости и потписан);**

formulari për aplikim ( i plotësuar në mënyrë të plotë dhe të nënshkruar);

1. **доказ о уплати депозита;**
dëshmi për pagesën e depozitës;

2. за закуп пољопривредног земљишта у државној својини документацију наведену у делу II тачка 3. овог огласа;
për qira të tokës bujqësore në pronësisë të shtetit të theksuar në pjesën II pika 3. të ksaj shpallje;

3. за коришћење пољопривредног земљишта у државној својини за пољопривредну производњу документацију наведену у делу II тачка 4. овог огласа
për shfrytzimit të tokës në pronësi të shtetit për prodhimtarin bujqësore dokumentet e theksuara në pjesën e II, pika 4. të ksaj shpallje.

4. за коришћење пољопривредног земљишта у државној својини за производњу енергије из обновљивих извора од биомасе и сточарства документацију наведену у делу II тачка 5.овог огласа.
për shfrytzimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit për prodhimin e energjisë nga burimet e restauruara prej biomase dhe blegtorisë dokumentet e theksuara në pjesën II, pika 5. e ksaj shpallje.

Формулар пријаве и адресиране коверте, односно штампане налепнице са адресом општине, се могу преузети сваког радног дана на писарници Општине Бујановац. Потребно је да се понуђач благовремено упозна са садржајем формулара пријаве.

Formulari i fletëparaqitjese dhe zarfat e adresuara, përkatsisht etiketat me adresën e komunës, mund të merren çdo ditë pune në notarin e Komunës së Bujanocit.Ofertuesi duhet të njoftohet me kohë mbi përmbajtjen e formularit të fletëparaqitjes.

Пријава на оглас се подноси у затвореној коверти на којој мора да пише:

Fletëparaqitja në shpallje dorëzohet në zarf të mbyllur në të cilën duhet të shkruhet:

На предњој страни:
Në faqen e përparme:

- **Адреса:** Општина Бујановац, улица**:** Карађорђа Петровића, бр.115**, Комисији за спровођење поступка давања у закуп пољопривредног земљишта у државној својини.**
  **Adresa:** Komuna e Bujanocit, rruga: Karagjorgje Petroviq, nr. 115, **Komisioni për zbatimin e procedurës së dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore.**

- Број јавног надметања __ (навести и КО)
  Numri i tenderimit __ (specifiko KK)

На задњој страни:
Në anën e pasme:

- име и презиме / назив и адреса понуђача
  emri dhe mbiemri / titulli dhe adresa e ofertuesit

Заједно са пријавом на оглас доставља се наведена документација.

Së bashku me kërkesën në shpallje dorëzohet dokumentacioni i theksuar .

**IV**
**-Рок за подношење пријаве -**
- Afati për dorëzimin e aplikacioneve -

**Рок за подношење документације за пријављивање је до 11:00 сати, дана 13.09.2017.године. Благовременим ће се сматрати све пријаве које стигну у писарницу Општинске управе општине Бујановац до наведеног рока без обзира на начин достављања.**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për paraqitje është deri në ora 11:00, më datë: 13.09.2017. Me kohë do të merren parasysh të gjitha fletëparaqitjet, të cilat arrinë në notarinë e Administratës komunale të komunës së Bujanocit, deri në afatin e cekur, pavarësisht nga mënyra e dorëzimit.

**Неблаговремене и непотпуне пријаве неће се разматрати.**

Aplikimet e vonuara dhe jo të plota nuk do të merren parasysh.

**V**
**- Јавно надметање -**
- Ankandi publik-

**Јавно надметање за давање у закуп и на коришћење земљишта из дела I. тачке 1. овог огласа одржаће се у згради Општине Бујановац, улица**: **Карађорђа Петровића, бр. 115, дана 14.09.2017.године, са почетком у 12:00 часова.**

Ankandi publik për dhënien me qira dhe në shfrytëzim të tokës bujqësore, nga pjesa e I. të pikës 1. të kësaj shpallje do të mbahet në ndërtesën e Komunës së Bujanocit, rruga: Karagjorgje Petroviq, nr.115, edhe ate më datë: 14.09.2017, duke filluar nga ora 12:00.

**VI**
**- Плаћање закупнине -**
**- Pagesa e qirasë -**

Закупнина ће бити прерачуната у евре, по средњем курсу Народне банке Србије, на дан јавног надметања.

Qiraja do të llogaritet në euro, me kursin mesatar të këmbimit të Bankës Kombëtare të Serbisë, në ditën e ankandit publik.

Закупнина се плаћа унапред у динарској противвредности по средњем курсу Народне банке Србије на дан уплате.

Qiraja paguhet paraprakisht me vlerë në dinarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Kombëtare të Serbisë në datën e pagesës.

**VII**
**–Уплата закупнине и средства обезбеђења плаћања –**
**-Pagesa e qiras dhe mjetet e siguruara të pagesës -**

Најповољнији понуђач је у обавези да у року од 8 дана, од правоснажности одлуке достави доказ о уплати закупнине, у износу утврђеном правоснажном одлуком о давању у

закуп пољопривредног земљишта у државној својини, умањеном за износ уплаћеног депозита, које ће доставити Министарству пољопривреде и заштите животне средине, преко Општинске управе Општине Бујановац.

Ofertuesi më i volitshëm është i detyruar që në afat prej 8 ditësh, nga dita e vendimit të paraqes dëshmin e pagesës së qirasë, në shumën e përcaktuar me vendim të formës së prerë për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, minus depozita e paguar, e cila do ti dërgohet Ministrisë së bujqësis dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, përmes Administratës komunale të Komunës së Bujanocit.

Уколико је период закупа дужи од једне године, закупнина се плаћа најкасније до 30. септембра за сваку наредну годину закупа, а уз уплатницу за прву годину закупа потребно је доставити и :

Nëse periudha e qiras është më shumë se një vit, qiraja paguhet jo më vonë se më datë 30 shtator

të çdo viti pasues të qiras, kurse krahas pagesës për vitin e parë të qirasë duhet të paraqitni edhe:

- гаранцију пословне банке у висини годишње закупнине пољопривредног земљишта или
  garancionin e bankës komerciale në shumën e qirasë vjetore të tokës bujqësore, apo

- уговор о јемству Министарства као повериоца и правног лица као јемца или
  kontratën e dorëzanis së Ministrisë si kreditor dhe të personit juridik si dorëzanës apo

- доказ о уплати депозита у висини једне годишње закупнине као средство обезбеђења плаћања закупнине, а који ће се у случају редовног плаћања рачунати као плаћена закупнина за последњу годину закуп.
  dëshmin për pagesën e depozitit në vlerë prej një vit qiraje si mjet të sigurimit të pagesës së qiras, e cila në rast të pagesave të rregullta do të llogaritet si e paguar qiraja për vitin e fundit të qiras.

Ову одлуку објавити у службеном гласилу јединице локалне самоуправе « Службени гласник општине Бујановац », на огласној табли Општинске управе Бујановац и месним канцеларијама, и на веб страни, с тим што ће се рок за подношење пријава рачунати од дана објављивања у Службеном гласилу јединице локалне самоуправе « Сл.гласник општине Бујановац ».

Ky vendim të shpallet në gazetën zyrtare të njësis së vetadministrimit lokale "Gazeta zyrtare e komunës së Bujanocit" në tabelën për shpallje të Administratës komunale të Komunës së Bujanocit dhe zyrat lokale dhe në faqen e internetit, me atë që afati pë paraqitje të llogaritet nga data e publikimit në Gazetën Zyrtare të njësis së vetadministrimit lokal "Gazeta zyrtare e komunës së Bujanocit."

**РЕПУБЛИКА СРБИЈА - REPUBLIKA E SERBISË**
**ОПШТИНА БУЈАНОВАЦ - KOMUNA BUJANOC**

**Бр. - Nr: 320-20**
**Дана – Më datë: 07.07.2017.г.-v**

**Председник Општине - Kryetari i Komunës,**
**Shaip Kamberi, c. p. – d. v.**

**131**

**Република Србија - Republika e Serbisë**
**Општина Бујановац - Komuna e Bujanocit**
**Општинска управа Administrata komunale**
**Одељење за привреду и локални економски развој**
**Drejtorati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik lokal**
**Бр. – Nr: 320-27**
**Датум - Më datë: 21.07.2017**

## ЈАВНИ ПОЗИВ ЗА ДОКАЗИВАЊЕ ПРАВА ПРЕЧЕГ ЗАКУПА ПОЉОПРИВРЕДНОГ ЗЕМЉИШТА У ДРЖАВНОЈ СВОЈИНИ НА ТЕРИТОРИЈИ ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ ЗА 2018. ГОДИНУ

## THIRRJE PUBLIKE PËR TA DËSHMUAR TË DREJTËN E PËRPARËSISË SË QIRASË NË TOKËN BUJQËSORE NË PRONËSI TË SHTETIT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË BUJANOCIT PËR VITIN 2018

У складу са Законом о пољопривредном земљишту („Службени гласник РС“, бр. 62/06, 65/08 – др. закон, 41/09 и 112/2015), Правилника о условима и поступку давања у закуп и на коришћење пољопривредног земљишта у државној својини («Сл. гласник РС» бр. 16/2017), Комисија за израду Годишњег програма заштите, уређења и коришћења пољопривредног земљишта/ надлежни орган јединице локалне самоуправе општине Бујановац, расписује **јавни позив** свим физичким и правним лицима, којим обавештава:

Në pajtim me Ligjin mbi tokën bujqësore (“Gazeta zyrtare e RS” nr. 62/06, 65/08 – ligji tjetër, 41/09 dhe 112/2015), Rregullores mbi kushtet dhe procedurën e dhënies me qira dhe mbi shfrytëzimin e tokës bujqësore në pronësi shtetërore ("Gazeta zyrtare e RS" nr. 16/2017), Komisioni për hartimin e Programit vjetor për mbrojtjen, rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore/ organi kompetent i njësisë së vetadministrimit lokal i komunës së Bujanocit, shpallë **thirrje publike** për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, me të cilën i njofton:

- власнике система за наводњавање, одводњавање, рибњака, пољопривредног објекта, стакленика, пластеника и вишегодишњих засада (воћњака и винограда који су у роду) на пољопривредном земљишту у државној својини и који су уписани у Регистар пољопривредних газдинстава и налазе се у активном статусу најмање три године (у даљем тексту: пољопривредна инфраструктура) и

- pronarët e sistemeve të ujitjes, kullimeve kultivuesit e peshqëve, të objekteve bujqësore, të serrave të qelqit dhe najllonit dhe të fidanishteve shumëvjeçare (pemishteve

dhe vreshtave të frytshme) në tokat bujqësore në pronësi të shtetit dhe të cilat janë të regjistruara në regjistrin e ekonomive bujqësore me status aktiv së paku tri vjet radhazi (në vazhdim të tekstit: infrastruktura bujqësore) dhe

- власнике домаћих животиња, који су и власници, односно закупци објеката за гајење тих животиња на територији јединице локалне самоуправе на којој се право пречег закупа остварује, који су уписани у Регистар пољопривредних газдинстава и налазе се у активном статусу најмање јуедну годину ( у даљем тексту: сточарсво),

- pronarët e kafshëve shtëpiake, të cilët janë edhe pronarë, përkatësishtë qiramarrës të objekteve për kultivimin e këtyre kafshëve në territorin e njësisë së vetadministrimit lokal në të cilën realizohet e drejta e përparësisë në qira, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e ekonomive bujqësore dhe që kanë status aktiv së paku një vit (në vazhdim të tekstit: blegtoria),

**да доставе потрбну документацију** ради доказивања права пречег закупа на пољоприввредном земљишту у државној својини на територији општине Бујановац за 2018 годину**, до дана 31.октобра 2017. године.**

**të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm** për ta dëshmuar të drejtën e përparësisë në qira ndaj tokës bujqësore në pronësi shtetërore në territorin e Komunës së Bujanocit për vitin 2018, **deri më 31 tetor 2017**.

## ДОКУМЕНТАЦИЈА О ДОКАЗИВАЊУ ПРАВА ПРЕЧЕГ ЗАКУПА
## DOKUMENTACIONI QË DËSHMON TË DREJTËN E PËRPARËSISË NË QIRA

**I.** Потребна документација за остваривање права пречег закупа **по основу власништва над пољопривредном инфраструктуром** је:
Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e të drejtës së përparësisë në qira **në bazë të pronësisë mbi infrastrukturën bujqësore** është:

1. Захтев за признавање права пречег закупа по основу власништва над инфраструктуром потписан од стране физичког лица, односно одговорног лица у правном лицу **(доставља подносилац захтева);**
Kërkesa për njohjen e të drejtës së përparësisë në qira në bazë të pronësisë mbi infrastrukturën të nënshkruar nga ana e personit fizikë, përkatësishtë të personit përgjegjës në personin juridik **(e paraqet parashtruesi i kërkesës);**

2. Доказ о власништву над пољопривредном инфраструктуром:
Dëshmia për pronësi mbi infrastrukturën bujqësore:

a) Извод из јавне евиденције о непокретности за пољопривредну инфраструктуру која је укњижена у јавној евиденцији о непокретности (прибавља јединица локалне самоуправе)и/или а)
Ekstrakti nga evidenca publike e patundshmërisë për infrastrukturën bujqësore e nënshkruar dhe e vërtetuar në pajtim me Ligjin mbi kontabilitetin për personin juridik, për infrastrukturën e cila nuk është evidentuar në evidencën publike për patundshmëritë **(e paraqet parashtruesi i kërkesës)** dhe /ose

b) Пописна листа и књиговодствена документација потписана и оверена у складу Законом о рачуноводству за правно лице, за инфраструктуру која није укњижена у јавној евиденцији о непокретности **(доставља подносилац захтева)** и/или
Lista regjistruese dhe dokumentacioni i kontabilitetit i nënshkruar dhe i vertetuar në pajtim me Ligjin mbi kontabilitetin për persona juridik, për ifrastrukturë e cila nuk është e regjistruar në evidencen publike mbi patundshmërinë **(e paraqet parashtruesi i kërkesës)** dhe /ose

c) Сагласност/одобрење Министарства надлежног за послове пољопривреде на инвестициона улагања за инфраструктуру која је подигнута након јула 2006. године, односно купопродајни уговор физичког лица (подносиоца захтева) са правним лицем које је подигло пољопривредну инфраструктуру у складу са тада важећим прописима **(доставља подносилац захтева)**
Pëlqimin/lejen e Ministrisë kompetente për punët e bujqësisë në mjetet investuese për infrastrukturë e cila është ngritur pas korrikut të 2006-tës, përkatësishtë kontrata e shitblerjes e personit fizikë (parashtruesit të kërkesës) me personin juridik i cili e ka ngritur infrastrukturën bujqësore në pajtim me rregullat që atëherë kanë qenë në fuqi **(e paraqet parashtruesi i kërkesës),**

3. Записник Републичке пољопривредне инспекције **(доставља подносилац захтева); (Напомена:** Сва лица која су заинтересована за остваривање права пречег закупа по основу инфраструктуре дужна су да благовремено, а најкасније до 1. септембра 2017.године, поднесу Захтев за излазак Републичке пољопривредне инспекције, односно ветеринарске инспекције. Записник Републичке пољопривредне инспекције је саставни део документације која се доставља до 31. октобра 2017. године и обавезно садржи тачно наведене све катастарске парцеле, или делове парцела, на којима је утврђена функционалност система за наводњавање, одводњавање, рибњака, пољопривредног објекта, стакленика, пластеника, као и рода воћњака и винограда.);
Procesverbali i Inspeksionit republikan të bujqësisë (**e paraqet parashtruesi i kërkesës**); **Vërejtje:** Të gjithë personat e interesuar për realizimin e të drejtës së përparësisë në qira në bazë të infrastrukturës janë të obliguar që në afat, më së voni, deri më 1 shtator 2017, ta parashtrojnë kërkesën për daljen e Inspeksionit republikan të bujqësisë përkatësisht Inspekcioni i veterinës. Procesverbali i inspekcionit republikan i bujqësisë është pjesë e dokumentacionit të parashtruar që dërgohet deri më 31 tetor 2017. dhe patjetër përmbanë të gjitha ngastrat kadastrale të shënuara me saktësi, ose pjesë të ngastrave, për të cilat është konstatuar funksionaliteti i sistemit për ujitje, vaditje, pellgjeve për kultivimin e peshkut, objektit bujqësorë, serave të qelqit dhe najllonit, si dhe pemishteve e vershtave të frytshme);

4. Доказ да је подносилац захтева носилац или члан Регистрованог пољопривредног газдинстава у активном статусу најмање три године (прибавља јединица локалне самоуправе);
Dëshminë se parashtruesi i kërkesës, bartësi ose anëtari i Ekonomisë bujqësore të regjistruar ka status aktiv së paku tre vite (e merr njësia e vetadministrimit lokal);

**II.** Потребна документација за остваривање права пречег закупа **по основу сточарства је:**
Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e të drejtës së përparësisë në qira **mbi bazën e blegtorisë** është si në vijim:

1. Захтев за признавање права пречег закупа по основу сточарства потписан од стране физичког лица, односно одговорног лица у правном лицу **(доставља подносилац захтева);**
Kërkesën për njohjen e të drejtës së përparësisë në qira në bazë të blegtorisë të nënshkruar nga ana e personit fizik, përkatësishtë të personit përgjegjës në personin juridik (e paraqet parashtruesi i kërkesës);

2. Доказ да је подносилац захтева носилац или члан Регистрованог пољопривредног газдинстава у активном статусу најмање једну годину (прибавља јединица локалне самоуправе);
Dëshminë se parashtruesi i kërkesës, bartësi ose anëtari i Ekonomisë bujqësore të regjistruar ka status aktiv së paku një vit (e merr njësia e vetadministrimit lokal);

3. Доказ да је правно или физичко лице власник домаћих животиња и власник, односно закупац објекта за гајење тих животиња са утврђеним бројем условних грла:
Dëshminë se personi juridik ose fizik është pronarë i kafshëve shtëpiake dhe pronarë përkatësishtë qiramarrës i objektit për kultivimin e atyre kafshëve, kushtimishtë me numrin e përcaktuar të krerëve:

a) Потврду о броју условних грла коју издаје Институт за сточарство Београд-Земун (изузев за коње коју издаје Пољопривредни факултет Београд-Земун), односно за територију АП Војводине Пољопривредни факултет Нови Сад-Департман за сточарство **– за Регистровано пољопривредно газдинство у систему уматичења (доставља подносилац захтева)**;
Vërtetimin mbi numrin eventual të krerëve të cilin e lëshon Instituti për blegtori Beograd – Zemun (përjashtimisht për kuajt të cilin e lëshon Fakulteti i bujqësisë në Beograd – Zemun), pëtkatësishtë për territorin e KA të Vojvodinës, Fakulteti i bujqësisë në Novi Sad – Depatamenti për blegtori – **për Ekonominë bujqësore të regjistruar në sistemin e amëzimit (e paraqet parashtruesi i kërkesës)**;

b) Записник Републичког ветеринарског инспектора **- за Регистровано пољопривредно газдинство које није у систему уматичења (доставља подносилац захтева). (Напомена:** Републички ветеринарски инспектор записником утврђује број условних грла

која обрачунава на осносву затеченог стања, односно **исправе лица о продаји, предаји на клање и извозу животиња**);
Procesverbalin e Inspektorit republikan të veterinës - **për Ekonominë bujqësore të regjistruar të cilat nuk janë në sistemin e amëzimit (e paraqet parashtruesi i kërkesës). (Vërejtje:** Inspektori republikan i veterinës me procesverbal e konstaton numrin eventual të krerëve të cilin e llogaritë në bazë të gjendjes së momentit, përkatësishtë në bazë të **dokumentit të personit për shitjen, dorëzimin ose therrjen dhe eksportin e bagëtive**);

4. Уговоре о закупу пољопривредног земљишта закључене са другим лицима за земљиште које се налази на територији јединице локалне самоуправе на којој се подноси захтев, а који су оверени од стране надлежног органа **(доставља подносилац захтева)**;
Kontratat për marrjen me qira të tokës bujqësore të lidhur me personat e tjerë për tokën e cila gjendet në territorin e njësisë së vetadministrimit lokal në të cilën parashtrohet kërkesa, të cilat janë të vërtetuara nga ana e organit kompetent (e paraqet parashtruesi i kërkesës),

5. Изјава подносиоца захтева којом даје сагласност да се изврши провера података код надлежних органа који су неопходни за реализацију јавног позива;
Deklarata e parashtruesit të kërkesës me të cilën e jep pëlqimin për kryerjen e verifikimit të të dhënave te organet kompetente që janë të domosdoshme për realizimin e thirrjes publike;
6. Изјава подносиоца захтева о тачности података, потписана од стране физичког лица, односно одговорног лица у правном лицу, дату под пуном кривичном, прекршајном и материјалном одговорношћу, која садржи:

- изјаву да је доставио све доказе који се односе на закуп пољопривредног земљишта на територији локалне самоуправе на којој је поднео захтев,
- списак повезаних лица.

**(Напомена: код физичких лица повезаним лицима сматра се:** деда, баба, мајка, отац, деца, супружник, усвојеник, ванбрачни партнер уколико имају пребивалиште на истој адреси; **код правних лица повезаним лицима сматра се:** правно лице и/или физичко лице које има најмање 25% учешћа у капиталу (акција, удела или гласова);

Deklarata e parashtruesit të kërkesës mbi të dhënat e sakta, të nënshkruar nga ana e personit fizik, përkatësisht të personit përgjegjës në personin juridik, të dhënë nën përgjegjësinë e plotë penale, kundërvajtëse dhe përgjegjësi materiale, e cila përmbanë:

